

## AKT THEMELEMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Apartments Albania” Sh.p.k.

Në Tiranë, sot në datën 11.02.2023, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themelohet shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **“Apartments Albania” SHPK**.

#### NENI 1

Shoqëria **“Apartments Albania” sh.p.k.** themelohet nga një ortak i vetëm dhe Ortaku themelues i shoqërisë është:

1. Krzysztof Eugeniusz DZIADKIEWICZ, biri i Jozef dhe i Elzbieta, lindur ne Zary, Poloni, me 16.07.1979, shtetas polak, mbajtes i Kartës së Identitetit me nr. DBZ151927, dhe nr. personal 79071604534, leshuar nga Republika e Polonisë me 13.01.2021, me skadencë 13.01.2031, me banim në Poloni.

#### NENI 2 Emërtimi

Emërtimi i plotë i shoqërisë është Shoqëria me Pergjegjesi të Kufizuar **“Apartments Albania” sh.p.k.**

#### NENI 3 Selia

Selia e Shoqerise **“Apartments Albania” sh.p.k.** do te ketë selinë në Durrës, në adresën: **Ruga e "Agaveve", Ndertesa me nr. pasurie 27/313-N2, Vol. 121, Faqe 117, Zona Kadastrale 8518.**

Perveç ushtrimit të aktivitetit në nivel qëndror, shoqëria ka të drejtë të hap degë dhe zyra përsaqësimi brënda vendit ose jashtë vendit. Selia e Shoqërisë mund të ndryshoj me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

#### NENI 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me përjashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendos Asambleja e Ortakëve (Ortakut të Vetëm).

## **NENI 5** **Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt të ushtrimit të aktivitetit të saj:

Bar – kafe, restorant, shërbime në hoteleri - turizëm, dhënen e dhomave me qira, shërbime mikëpritjeje, informim, reklamim dhe guidë turistike, ndërmjetësim në fushën e shërbimeve turistike dhe imobiliare, këshillim në fushën e turizmit, marketingut dhe studime tregu.

Këshillime në fushën psikologjike dhe psiko-terapeutike.

- Agjent imobiliare në shitblerje të pasurive të paluajtëshme (tokë dhe ndërtesa) usufruti dhe enfiteozi.

Tregtimin me shumicë dhe pakicë, import-eksport, edhe nëpërmjet internetit, të mallrave të ndryshëm.

Shoqëria mund të përdor të gjitha të ardhurat kombëtare, rajonale, evropiane, për realizimin e objektit të shoqërisë, të parashikuara nga ligjet për stimuj për ndërmarrësi.

Për të arritur qëllimin e saj, shoqëria me një vendim të Asamblesë së Ortakëve (Ortakut të vetëm) mund të themelojë shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja dhe/ose të blejë aksione në shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja, të hapë degë të shoqërisë brënda dhe jashtë Shqipërisë.

## **NENI 6** **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lekë. Ky kapital përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë prej 10.000 leke, e nënshkruar 100 % nga ortaku i vetëm. Kapitali themeltar shoqerisë ndahet në kuota dhe pjesë të zoteruara prej ortakut, si me poshtë.

Emri	Perqindja %	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit
Krzysztof Eugeniusz DZIADKIEWICZ	100 %	1	10.000 ALL

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, në emër të shoqërisë pas formimit të saj.



**NENI 7**  
**Administratori**

1. Administrator i shoqerise është Krzysztof Eugeniusz DZIADKIEWICZ, biri i Jozef dhe i Elzbieta, lindur ne Zary, Poloni, me 16.07.1979, shtetas polak, mbajtes i Kartës së Identitetit me nr. DBZ151927, dhe nr. personal 79071604534, leshuar nga Republika e Polonisë.

**NENI 8**  
**Ligji aplikueshëm**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar si dhe në bazë të Statutit dhe këtij Akti Themelimi.


**NENI 9**  
**Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është përpiluar në gjuhën shqipe dhe polake, në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

Autorizohet Avokate Znj. Anjeza Rusi me nr. personal I45412011R që të kryejë regjistrimin përkatës të shoqërisë në QKB.

**ORTAKU THEMELUES**

Krzysztof Eugeniusz DZIADKIEWICZ

  
Krzysztof Eugeniusz DZIADKIEWICZ